



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 581 Prot.

Tiranë, më datë 03.06.2022

VENDIM
Nr. 207, datë 03.06.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 03.06.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit kërkimor-shkencor në vazhdim “Tempulli i Shtyllasit” me aplikues Bashkim Lahi dhe zhvillues Akademia e Studimeve Albanologjike, drejtues projekti z. Bashkim Lahi;
2. Të plotësohet me projektin e konservimit dhe restaurimit të kolonës sipas VKM-së nr.1099 datë 24.12.2020 “Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore”;
3. Pas përfundimit të projektit, një kopje e dokumentacionit si dhe lista e gjetjeve arkeologjike të depozitohen pranë IKTK-së;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi.
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO



KRYETAR
Elva MARGARITI